



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-400/04-0015498-2/26 dt. 27.03.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenet 14 dhe 31 paragrafi 2.15, të Rregullores Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, dhe pas shqyrtimit të Propozim-Vendimit të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural Nr. 01-400/04-0015498/26, dt. 25.03.2026, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet** Propozim-vendimi i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural Nr. 01-400/04-0015498/26, dt. 25.03.2026, dhe i lejohet shpallja e Thirrjes Publike për Subvencionimin e fermerëve për pagesë direkte për qumësht, në shumë prej 0.10 € (dhjet cent) për litër qumësht, për fermerët e Komunës së Mitrovicës së Jugut.
2. Drejtoria për Bujqësi dhe zhvillim Rural obligohet që ti zhvillojë procedurat konform kriterëve dhe dispozitave të Rregullores Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, dhe dispozitave ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
3. Thirrja Publike për realizimin e këtij projekti e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi, së bashku me kriteret do të publikohen në web faqen e Komunës, dhe e njëjta do të qëndrojë e hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga momenti i publikimit.
4. Në përputhje me Rregulloren Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, dhe me propozimin e Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Kryetari i Komunës do të formojë Komisionin Vlerësues i cili do të bëjë vlerësimin e aplikacioneve në përputhje me kriteret e përcaktuara me Thirrjen Publike.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.



6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës

Faton Peci

Shtojcë:

Propozim-Vendimi i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural Nr. 01-400/04-0015498/26, dt. 25.03.2026;
Thirrja Publike e DBZHR-së.

Ti dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
- 1x1 Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- 1x1 Arkivit.

